

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
PREMIUM INVESTMENTS SHPK

Sot, më datë 19.12.2023 bazuar në ligjin 9901, datë 14.04.2008, Ligji tregtar dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar dhe në ligjin 9723, 03.05.2007 për regjistrimin e biznesit i ndryshuar, themeluesit:

PRIME CAPITAL, me NUIS K92107012P, Rruga Petrelë Mullet km 10 Tiranë-Elbasan, Kantjeri pranë Restorant ALPIAG Mullet, Tiranë ;

FIRST WOOD me NUIS K46919625I, Autostrada e Devollit, Lagjja 2, Godina nr.02, Bilisht, Korçë vendosën të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar

Redaktoi dhe nënshkroi aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " PREMIUM INVESTMENTS SHPK", si më poshtë:

KAPITULLI I

EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

Neni 1

Emërtimi dhe Ortakët Themelues

- 1.1 Shoqëria emërtohet **PREMIUM INVESTMENTS SHPK** (në vijim "Shoqëria").
- 1.2 Ortakët themelues të Shoqërisë janë:
 - 1.2.1 **PRIME CAPITAL**, me NUIS K92107012P, Rruga Petrelë Mullet km 10 Tiranë-Elbasan, Kantjeri pranë Restorant ALPIAG Mullet, Tiranë ;
 - 1.2.2 **FIRST WOOD** me NUIS K46919625I, Autostrada e Devollit, Lagjja 2, Godina nr.02, Bilisht, Korçë


Neni 2

Forma

- 2.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet prej këtij Statuti.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 3

Selia



- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga "Godina 2, lagjia 2, autostrada e Devollit, Bilisht, Korçë". Transferimi i selisë mund të behet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të miratuar me votën pro të ortakëve të përcaktuar në nenin 11.4 të Statutit.
- 3.2 Asambleja e Ortakëve, me votën pro të ortakëve të përcaktuar në nenin 11.4 të Statutit, mund të vendosë hapjen e degëve dhe perfaqësive të tjera në Shqipëri ose jashtë saj.

Neni 4 Objekti

- 4.1 Shoqëria ka Për Objekt veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në vijim:
-
- a) Ushtrimin e aktiviteteve në fushën e hoteleri turizmit nëpërmjet studimit, planifikimit, ndërtimit dhe vënies në funksion të të gjitha kapaciteteve logjistike dhe njerëzore në përmbushje të kësaj veprimtarie.
- b) Projektimi, zbatimi dhe vënia në funksion e objekteve të ndryshme ndërtimore, përfshirë ato civile, industriale si dhe restaurimin e tyre, në funksion të aktivitetit cituar në pikën 4.1(a), më sipër.
- c) Zhvillimi, qiraja, shitja dhe blerja e pasurive të paluajtshme dhe kryerja e investimeve të lidhura me to.
- d) Kryerja e çdo veprimtarie të ligjshme në funksion të fushave të veprimtarisë të referuara në pikat 4.1(a, b, c) të këtij Statuti.
- 4.2 Shoqëria mund të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative në *consortium*-e edhe të përkohshme, *joint venture* ose (ii) të zotërojë, të blejë ose të shesë kuota apo aksione në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të, jo si aktivitet parësor,
- 4.3 Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.
- 4.4 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronat e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

Neni 5 Kohëzgjatja



- 5.1 Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biënesit. .

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100,000 Lekë dhe është aktualisht i ndarë në 2 kuota si më poshtë. Kapitali mund të shlyhet me kontribute në para dhe/ose kontribute në natyrë.
- 6.2 Kapitali themeltar është i nënshkruar si më poshtë:
- **PRIME CAPITAL SHPK** për vlerën 50.000 Lekë e cila përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë;
 - **FIRST WOOD SHPK** për vlerën 50.000 Lekë e cila përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë;
- 6.3 Secili prej ortakëve do t'i komunikojë me shkrim Shoqërisë adresën e tij fizike dhe e-mail ku mund të kryhen të gjitha njoftimet në bazë të këtij Statuti ose ligjit të aplikueshëm.

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë

- 7.1 Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kurdo dhe për më shumë se një herë, përmes kontributit në para ose në natyrë, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe sipas përcaktimeve të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me parashikimet statutores.
- 7.2 Në rast zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë, ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit në proporcion me kuotat që ata zotërojnë. Vendimi i Asamblesë së Ortakëve që vendos për zmadhimin e kapitalit duhet të vendosë, ndër të tjera, edhe afatin brenda të cilit duhet të kryhet shlyerja e tij, si dhe mënyrat e shlyerjes së tij.
- 7.5 Nëse kapitali i Shoqërisë nuk nënshkruhet dhe shlyhet tërësisht, kapitali zmadhohet me një vlerë të barabartë me nënshkrimet dhe shlyerjet e mbledhura, vetëm nëse vendimi përkatës i Asamblesë së Ortakëve e ka parashikuar shprehimisht. Në të kundërt, zmadhimi i kapitalit do të konsiderohet tërësisht i pushlyer.
- 7.6 Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet vetëm pasi kuotat e emetuara më parë të jenë shlyer tërësisht.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë

- 8.1 Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.



- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 9

Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 9.2 Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËT

Neni 10


Asambleja e ortakëve, të drejtat e pjesëmarrjes dhe votës, thirrja

- 10.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 10.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Ortakëve, të shprehë mendimin e tij dhe ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës në pronësinë e tij. Ortaku nuk mund të votojë në një mënyrë me një pjesë të kuotës dhe në një mënyrë tjetër me pjesën e mbetur të saj.
- 10.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër (me përjashtim të Administratorit), edhe jo ortak, i pajisur me prokurë, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, prokura do të mund të lëshohet vetëm për një Asamble ortakësh, dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe vijuese të saj.
- 10.4 Ortaku nuk mund të japë autorizim për të votuar për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 10.5 Asambleja e Ortakëve mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri.
- 10.6 Asambleja e Ortakëve mund të thirret prej Administratorit, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkesë me shkrim drejtuar Administratorit. Nëse Administratori refuzon të thërrasë Asamblenë brenda 3 ditëve pune, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin vetë Asamblenë në përputhje me nenin 82,



paragrafi i dytë, 83 (paragrafi i parë) dhe 84 (paragrafi i parë) të Ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("Ligji Tregtar"). Në çdo rast, Asambleja e Ortakëve duhet të mblidhet të paktën një herë në vit brenda muajit qershor, me qëllim që të diskutojë dhe miratojë bilancin vjetor të vitit të mëparshëm fiskal.

- 10.7 Asambleja e Ortakëve duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje ose me postë elektronike me evidencë marrje dërguar ortakëve në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve është e pavlefshme nëse nuk janë thirrur të marrin pjesë të gjithë ortakët e saj.
- 10.8 Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Ortakëve dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mblidhet.
- 10.9 Asambleja e Ortakëve konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur rregullisht edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që të gjithë ortakët e Shoqërisë të jenë të pranishëm dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë.
- 10.10 Asambleja e Ortakëve mund të zhvillohet me video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës.
- 10.11 Nëse përmbushen këto kushte, Asambleja e Ortakëve konsiderohet e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari.
- 10.12 Asambleja e Ortakëve kryesohet nga një Kryetar i zgjedhur nga ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Nëse prania e një noteri nuk është e nevojshme, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë ortak.
- 10.13 Kryetari i Asamblesë së Ortakëve ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe/ose autorizimet dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblesë e Ortakëve dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshmërisht. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë diskutimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat e votimit.
- 10.14 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë së Ortakëve, nëse do të jetë e nevojshme, duhet të përgatiten menjëherë pas mbajtjes së saj dhe duhet të nënshkruhen prej Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë së Ortakëve, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga ligji dhe regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.



10.15 Pavarësisht nga sa më sipër, një vendim i Asamblesë së Ortakëve mund të merret vlefshëmrisht edhe me anë të një vendimi qarkullues me shkrim me kusht që ky vendim qarkullues të nënshkruhet nga të gjithë ortakët. Propozimi i vendimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sqarues bashkëngjitur duhet t'i dërgohet me rradhë të gjithë ortakëve, me çdo mjet të pershtatshëm që provon marrjen e tij nga këta të fundit. Nga propozimi duhet të rezultojë në mënyrë të qartë çështja në rend të ditës dhe gjithë sa është e nevojshme për të siguruar informacionin e duhur mbi ceshtjen në fjalë, si dhe teksti përfundimtar i vendimit që duhet nënshkruar. Nënshkrimi i vendimit nga secili prej ortakëve shpreh pozicionin përkatës të secilit prej tyre. Kuorumi i vendimarrjes është ai që është i parashikuar në nenin 11 të Statutit. Do të konsiderohet datë e vendimarrjes data në të cilin është materializuar nënshkrimi i ortakut të fundit. Këto vendime dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues që shpreh vullnetin e tyre duhet të regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.


Neni 12

Administratori

12.1 Administrimi i Shoqërisë "**Premium Investments**" shpk në kuptim të nenit 207 të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe marrëveshjes për krijimin e grupit kontrollues do të kryhet përmes administratorit Albert Çoku.


12.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e Ortakëve;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqes këto dokumente përpara asamblesë së Ortakëve për miratim;
- e) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryej regjistrimet dhe të dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportoj përpara asamblesë së Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



h) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

- 12.3 Administratori i Shoqërisë ka për detyrë të informojë pa vonesë ortakët e Shoqërisë në lidhje me veprimet e tyre ose të Shoqërisë, të paktën çdo 3 muaj (duke përfshirë dhe pa u kufizuar në: transaksionet e kryera nga Shoqëria, të ardhurat dhe shpenzimet mujore për tipologji veprimi, shërbimi e produkti të krahasuara me plan biznesit dhe buxhetin e miratuar dhe të dhënat e vitit të mëparshëm) ose, në çdo moment, brenda pesë ditëve kalendarike. Në vijim të kërkesës së secilit prej ortakëve. Nuk ekziston asnjë kufizim apo ndajim i vlerësuar nga Shoqëria për mosdhënie informacioni sipas nenit 18 të Ligjit Tregtar.
- 12.4 Administratori zbaton politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Ortakëve. Administratori ka kompetenca për administrimin e zakonshëm të Shoqërisë në përputhje dhe në kufijtë e kompetencave të përcaktuar në vendimin e emërimit, nëse ka, dhe/ose në këtë Statut. Administratorit i takon, gjithashtu, përfaqësimi i Shoqërisë kundrejt të tretëve si dhe të gjitha proceset gjyqësore.
- 12.5 Në lidhje me administrimin e jashtëzakonshëm të Shoqërisë, Administratori mund të veproj vetëm pasi të jenë autorizuar shprehimisht nga Asambleja e Ortakëve e cila vendos me shumicën e parashikuar në nenin 11.4 të Statutit.
- 12.6 Administratori mund të emërojë përfaqësues me autorizim/prokurë të posaçme për akte ose kategori aktesh, brenda kufijve të kompetencave të deleguara nga ky Statut, ligji dhe/ose vendimi i Asamblesë së Ortakëve.
- 12.7 Administratori mund të shkarkohet, në çdo moment, edhe pa shkak, nga Asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar në Ligjin Tregtar.
- 12.8 Administratori i Shoqërisë ka për detyrë të informojë pa vonesë ortakët e Shoqërisë në lidhje me veprimtarinë e tyre ose të Shoqërisë, të paktën çdo tre muaj (duke përfshirë por pa u kufizuar në: transaksionet e kryera nga Shoqëria, të ardhurat dhe shpenzimet mujore për tipologji veprimi, shërbimi e produkti të krahasuara me plan biznesin dhe buxhetin e miratuar dhe të dhënat e vitit të mëparshëm) ose, në çdo moment, brenda pesë ditëve kalendarike, në vijim të kërkesës së secilit prej ortakëve. Nuk ekziston për ortakët asnjë kufizim apo ndalim i vlerësuar nga Shoqëria për mosdhënie informacioni sipas nenit 18 të Ligjit Tregtar.
- 12.9 Moszbatimi i sa më sipër me veprim apo mosveprim nga ana e Administratorit ose kryerja e veprimeve në tejkalim të kompetencave pa miratimin ose autorizimin paraprak, sipas rastit, të Asamblesë së Ortakëve është, ndër të tjera, shkak për shkarkimin e Administratorit dhe/ose pavlefshmërinë e veprimeve të tij.



KAPITULLI IV

EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 13

Eksperti kontabël i regjistruar

- 13.1 Nëse kërkohet nga ligji apo një vendim i tillë merret nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një apo më shumë ekspertëve kontabël të regjistruar.
- 13.2 Eksperti kontabël i regjistruar mund të shkarkohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga ligjet në fuqi.

Neni 14

Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 14.2 Bilanci dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratorit dhe raporti që, eventualisht, hartohet prej ekspertit kontabël të emëruar, miratohen prej Asamblesë së Ortakëve me shumicën e votave të kërkuara në paragrafin 11.2 më sipër.
- 14.3 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar, me përjashtim të rastit kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 15

Fitimet

- 15.1 Me kusht që të jetë respektuar neni 77 i Ligjit Tregtar, fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor i Shoqërisë pasi i është zbritur edhe e gjithë shuma që Asambleja e Ortakëve vendos lirisht të vendosi mënjane si rezerva diskrecionale, me votën pro të ortakëve të parashikuar në nenin 11.4 më sipër i shpërndahen ortakëve proporcionalisht me kuotat në kapitalin e Shoqërisë që ata kanë perkatesisht në pronësi.
- 15.2 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë lirisht të mbajë te gjithë fitimet ose një pjesë të tyre si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve — tërësisht apo pjesërisht në vitet ushtrimore pasardhës.



KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 16

Shpërndarja

- 16.1 Shoqëria shpërndahet në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Ortakëve me shumicën e parashikuar në nenin 11.4 më sipër.

Neni 17

Likuidimi

- 17.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në likuidim.
- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e ortakëve, me votën pro të ortakëve të parashikuar në nenin 11 më sipër, do të emërojë një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivitet të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 17.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e ortakëve do të marrë vendim në lidhje me bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuidatorit dhe mbi përfundimin e procedurës së likuidimit.
- 17.4 Pas kryerjes së pagesës së kreditorit/ëve dhe tërheqjes së kredive, likuidatori/ët do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, proporcionalisht me kuotat që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.

KAPITULLI VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij Statuti dhe mes Shoqërisë dhe ortakëve apo mes ortakëve, do të lihen nën kompetencën ekskluzive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 19

Të Tjera



Nënshkruar sot më datë 19.12.2023 në qytetin e Tiranës, nga Ortakët:

PRIME CAPITAL
Përfaqësuar nga Administratori
ILIR BEJLERI



FIRST WOOD
Përfaqësuar nga Administratori
ALBERT ÇOKLI

